

# Sejdiu dhe Thaçi, pakt për zgjedhjet e reja

## Dy partitë e mazhorancës ranë dakord për votime në pranverën e 2011-s

Partnerët e koalicionit PDK-LDK janë marrë vesh në parim që vendin ta çojnë drejt zgjedhjeve të reja dhe ta lënë anash zgjedhjen e Presidentit deri në krijimin e institucioneve të reja. Pajtimi është mbërritur në takimin që kanë zhvilluar të enjten pasdite dy liderët e këtyre subjekteve politike, Hashim Thaçi e Fatmir Sejdiu. Takimi është zhvilluar në një nga sallat e Presidencës dhe në të, përveç Sejdiut, nga radhët e LDK-së kanë marrë pjesë edhe Eprem Kryeziu e Ramë Manaj. Thaçi, i vetëm ka përfaqësuar PDK-në në takim. Një pjesëmarrës në takim i ka thënë të përditshmes "Koha Ditore" se "Atmosfera e takimit nuk ka qenë edhe aq e ngrohtë, megjithatë partnerët e koalicionit kanë arritur që ta hapin diskutimin rreth kohës kur do të mund të mbaheshin zgjedhjet. Nuk është saktësisht ndonjë datë, apo muaj, por është shprehur pajtimi se i gjithë procesi duhet të mbështetet mbi Kushtetutën e Kosovës". "Në parim, Thaçi e Sejdiu janë pajtuar që të gjejnë rrugë për t'u shmangur zgjedhjeve të jashtëzakonshme, të cilat sipas Kushtetutës do të mbaheshin 45 ditë pas shpalljes së tyre nga ushtruesi i detyrës së Presidentit, Jakup Krasniqi". Liderët e të dyja subjekteve politike e kanë lënë të hapur mundësinë që të takohen më shpesh ditëve në vijim. Aty nuk është përmendur fare opsioni i nxjerrjes së një kandidati të ri nga LDK-ja për President të radhës.

Takimi është mbajtur larg vëmendjes së mediave. Gjatë kësaj jave është raportuar për ftohje të marrëdhënieve midis tyre, pas konstatimit të Gjykatës Kushtetuese se Sejdiu kishte shkelur Kushtetutën duke mbajtur postin e Presidentit dhe atë të kryetarit të LDK-së. Me marrëveshjen për koalicion, LDK-së i takon posti i Presidentit. Pas dorëheqjes së Sejdiut, LDK-ja ka insistuar në zgjedhjen e pasuesit të tij për mandat të plotë, por PDK-ja deri tani ka insistuar që të mos ia krijojë mundësinë. Gjatë ditës janë shprehur mospajtime midis partnerëve të koalicionit për kohën se kur do të duhej të mbaheshin zgjedhjet. PDK-ja po ngutet që ato të organizohen brenda vitit, por LDK-ja po druan se kjo do të ishte e barabartë me manipulim votash. "Nuk ka të drejtë askush që për shkak të një presioni të kohës të bëhet ngutje, qoftë për të dhënë propozime për kandidat për President, apo për të pasur zgjedhje këtë vit", ka thënë Ismet Beqiri, shef i grupit parlamentar të LDK-së. LDK është vlerësuar se duhet shkëputur koalicionin me PDK-në. Grupi parlamentar i kësaj partie ka mbajtur mbledhje, ku është prezantuar ky disponim. "Ka ardhur koha që LDK-ja duhet të flasë qartë dhe me një zë. Duhet t'i tregojë elektoratit të vet se kjo ose ajo rrugë është më e mira për t'u ndjekur. Prandaj është më se e nevojshme një konsultë me kryetarin e partisë", ka thënë një nga zyrtarët e lartë të LDK-së. Zëvendëskryeministri Kuçi ka thënë se "marrëdhëniet midis partnerëve të koalicionit janë të konsoliduara, funksionale dhe institucionale" dhe se kurrëgjë të jashtëzakonshme nuk ka midis tyre. Paralelisht zhvillimeve midis partnerëve të koalicionit, po shihet një afri e kampit opozitar nga PDK-ja. AKR-ja veç është ditur se ka raportet më të afërta me të, ndërkaq zyrtarët e AAK-së dhe të LDD-së kanë folur të enjten me gjuhë të zbutur për

### Anëtari i kryesisë

#### Lajçi: Sejdiu të largohet nga LDK

Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ali Lajçi kërkoi dorëheqjen e Fatmir Sejdiut edhe nga posti i kryetarit të partisë. Lajçi tha se nuk i takon askujt të pretendojë të gëzojë pozitën e kryetarit të vendit, të Kryeministrit ose kryetarit të partisë, i cili ka shkelur Kushtetutën e vendit. Ai këto komente i bëri pasi lëshoi mbledhjen e Kryesisë së LDK-së. Lajçi theksoi se dorëheqjen e kryetarit të LDK-së e kërkon për të krijuar një imazh më të mirë të kësaj partie. Po ashtu, Lajçi kërkoi angazhim më të madh për reforma në LDK, në mënyrë që të mbahen zgjedhjet e rregullta në këtë parti. Ndërkaq, Sejdiu duke komentuar deklaratat e anëtarit të Kryesisë, Ali Lajçi, tha se vetëm kryetari i LDK-së është i autorizuar të flasë për vendimet e LDK-së.

partinë e Kryeministrit Thaçi. Madje, në disa momente është lavdëruar Kryeministri. Një ditë më parë, nënkryetari i parë i AAK-së, Blerim Shala, ka zhvilluar një

takim sekret me Kryeministrin, i pari i konfirmuar qëkur Thaçi mban drejtimin e qeverisë. Në të është folur për kohën kur duhen mbajtur zgjedhjet.



### Deklarata

#### Ish i dërguari i BE-së për Ballkanin komenton dorëheqjen Petritsch: Sejdiu gaboi. Të linte kreun e LDK-së, jo Presidencën



Nga Gjenerali  
NEFAIL MALIQI

"Liderët e Kosovës sot duhet të lënë anash ambicjet karrieriste dhe duhet t'i japin prioritet lobimit të nisur për njohje të reja nga vendet botërore, të cilat ende hezitojnë për ta njohur shtetin e Kosovës"

Largimi i papritmas i Fatmir Sejdiut nga posti i Presidentit të Kosovës jo vetëm që ka habitur ndërkombëtarët, por ky gjest i Sejdiut nuk është mirëpritur. Kështu mendon edhe ish-i dërguari i BE-së për Ballkanin, ambasadori Wolfgang Petritsch, i cili lajmin e ka pranuar marrë me keqardhje lajmin. Diplomati austriak duke folur për largimin e Sejdiut nga Presidencia deklaroi për "Shqip" se "Fatmir Sejdiu ka bërë hap të gabuar që është posti i kreut të Republikës së Kosovës. E them këtë me plot bindje dhe shqetësim, sepse shumë me rëndësi është shteti se partia, sidomos për Kosovën në këto momente vendimtare. Kosova nuk e meriton një kaos të tillë politik". Sipas ambasadorit Petritsch, Kosova e as populli i saj nuk duhet të tolerojë regresin si viktimitë e lëvizjeve të liderëve nga ai post në këtë post për interesa partiake. "Ky veprim i ngutur i Sejdiut nuk i përgjigjet momentit aq më tepër kur Kosova këtyre ditëve është duke ndërtuar shtetin e vet, në pritje të njohjeve të reja edhe nga shumë vende të tjera të botës", ka thënë diplomati austriak për "Shqip". Në vazhdim të bisedës sonë z. Petrich theksoi se "Sejdiu do të duhej më mirë të largohej nga drejtimi i LDK-së sesa nga Presidencia e shtetit. Një veprim i tillë do të ishte më korrekt dhe më i çmueshëm si nga vendorët ashtu edhe nga ndërkombëtarët. Dhe më habit fakti se pse Sejdiu një gjë të tillë nuk e paska bërë më herët, nëse Kushtetuta e Kosovës nuk po mundësoi ushtrimin e dy funksioneve, meqë Kushtetuta nuk daton nga pardje?! Prandaj edhe kjo vonesë është për t'u gjykuar dhe duhet të japë përgjegjësi ndokush, për një akt të tillë të vonuar." Në mesazhin e diplomatit të njohur, mikut të Kosovës z. Petritsch, drejtuar liderëve dhe qeverisë së Kosovës thuhet se "liderët e Kosovës sot duhet të lënë anash ambicjet karrieriste dhe duhet t'i japin prioritet lobimit të nisur për njohje të reja nga vendet botërore, të cilat ende hezitojnë për ta njohur shtetin e Kosovës. Kaosi politik në Prishtinë është në rend të parë në dëm të liderëve që bëjnë lëvizje të pamatur në këto momente vendimtare të vendit të juaj, kur e tërë bota sot i ka sytë nga Kosova, pas verdiktit të GjND-së. Prandaj energjia e tyre duhet përqendruar në lobime, anëtarësimin e Kosovës në OKB-dhe dhe integrimet e saj në instancat e tjera ndërkombëtare".

### Debati

Ekspertët, presion qeverisë për procesin

## Kriza politike po dëmton regjistrimin e popullsisë

Presionet mbi institucionet e Kosovës, Qeverinë dhe Kuvendin, për të mos lejuar dështimin e procesit të regjistrimit të popullsisë kanë filluar të intensifikohen, veçmas nga ekspertët të kësaj fushe dhe nga deputetët të Kuvendit. Ata pohojnë se vonesat janë shumë të mëdha në këtë aspekt dhe se është momenti i fundit për të ecur me hapa të shpejtë, ndonëse parashikohet se mbajtja e procesit të regjistrimit të popullsisë bashkë me zgjedhjet e ardhshme, që pritet të mbahen në gjashtë muajt e ardhshëm, do ta vështirësojnë shumë organizimin e këtij projekti. "Projekti i regjistrimit nuk guxon të dështojë. Le të menaxhohen si të duan situatat, por ky projekt shumë madhor për Kosovën nuk guxon të dështojë", ka porositur Rifat Blaku, i emëruar nga Kuvendi kryesues i komisionit qendror për regjistrimin e

Tërmkollit ka përmendur se me ligj kryetar i këtij komisioni duhet të jetë zv.ministri i Administratës Publike dhe kjo ka ndikuar në ndryshimin e përbërjes së Komisionit, gjë që sipas saj "është e pakuptimtë"

popullsisë në kohën sa ishte zëvendësimin e Administratës Publike. Më herët Melihate Termkollit, e cila për tre vjet të mandatit të qeverisë së kaluar është marrë me këtë proces, ka numëruar një varg procesesh, në të cilat qeveria ka stagnuar sa i përket regjistrimit. Sipas saj, institucionet janë vonuar me ligjin e ri për regjistrimin e popullsisë, meqë qeveria e ka vonuar së tepërmi procedimin e tij në Kuvend, pastaj faktin se ky organ po ashtu ende nuk e ka rregulluar çështjen e komisionit qendror për regjistrim, meqë riformatizimi i qeverisë ka diktuar ndryshimin në përbërjen e këtij komisioni. Tërmkollit ka përmendur se me ligj kryetar i këtij komisioni duhet të jetë zv.ministri i Administratës Publike dhe kjo ka ndikuar në ndryshimin e përbërjes së Komisionit, gjë që sipas saj "është e pakuptimtë"

### Prishtinë

Presidenti i përkohshëm takohet me kreun e institucionit

## KQZ: Gati për zgjedhje kur të kërkohet

"KQZ-ja është teknikisht e gatshme për organizimin e zgjedhjeve nëse do të kërkohet", ka deklaruar dje kryetarja e këtij institucioni, Valdete Daka. "Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, u takua me kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, si dhe me kryeshëfën e Sekretariatit të KQZ-së, Xhemajl Peçani", ka njoftuar kabineti për informim i Presidencës. Gjatë takimit, kryetarja e KQZ-së theksoi se ky institucion është teknikisht i gatshëm për organizimin e zgjedhjeve nëse do të kërkohet.



Duke folur për sfidat me të cilat do të përballet KQZ-ja, në rast të kërkesës për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme brenda 45 ditësh, Daka ka kërkuar nga Krasniqi mirëkuptim. "Për të siguruar një proces të ndershëm, të lirë dhe transparent, sipas saj, duhet të plotësohen disa kushte që kanë të bëjnë me sigurimin e buxhetit në kohën e duhur, përkrahje logjistike, çështje që kanë të bëjnë me listat e votuesve, informimin publik, çështjen e votimit jashtë vendit dhe përkrahjen e faktorit ndërkombëtar", thuhet në komunikatë. Ndërkaq, në lidhje me procesin zgjedhor në Komunën e Rahovecit, ajo theksoi se KQZ është e gatshme për t'i organizuar ato brenda 45 ditësh, nëse do të kërkohet.



**KAM INTERNATIONAL SH.P.K.**  
**TURKISH AIRLINES GSA**

### Njoftim Punësimi

Kompania **KAM International SHPK**, përfaqësuese e kompanisë ajrore Turkish Airlines në Tiranë kërkon punonjës në pozicionin e **agjentit të shitjes së biletave**.

Kandidatën duhet të njohin mire gjuhët Angleze dhe Turke.

Kërkesat dhe CV duhet të dorëzohen brenda datës **15 Tetor 2010**.

Adresa:

**Tirana International Hotel, Kati Përdhe, Lobi i biznesit**

**E-mail: tkkamgsa@icc-al.org,**

**Tel: 2272292, Mobil: 0672023875**